



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria e Arsimit
07/Zyrtarisht
Më: 17.01.2023

Bazuar në nenin 20 pika 1, Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, i datës 29/08/2011, nenin 5, pika d e Ligjit për arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr. 03/L-068, të datës 21/05/2008 dhe Udhëzimit Administrativ i MASHT – it për detyrat, përgjegjësit, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, nr. 151/2020, të datës 22/12/2020, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Deçanit, shpallë:


K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDITË TË PUNËS

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita - Koeficienti	Vendi	Numri i pozitave
1	Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Kuvendi i Verrave të Llukës" -	Drejtor Shkolle Koeficienti: 7.8	Llukë e Epërme <u>RISHPALLJE</u>	1
2	Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Lidhja e Prizrenit"	Drejtor Shkolle Koeficienti: 7.8	Deçan	1
3	Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Sylë Alaj"	Drejtor Shkolle Koeficienti: 7.8	Dranoc	1

Lloji i vendit të punës: **Me mandat**
Numri i Pozitave: **Tre (3) pozita**
Kategoria Funksionale: **Nivel drejtues**
Kohëzgjatja e emërimit: **Katër (4) vjet**

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor



Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit parashihen në Nenin 3 të U.A nr. 151/2020, të datës 22/12/2020

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsimin të përgjithshëm;
- Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 330 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
- Fakultetit katërvjeçar (kualifikimin prej ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Bachelor katërvjeçar (kualifikim prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar).
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit, sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
- Të kenë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të aprovuar nga MASH, sipas rekomandimeve nga KSHLM;
- Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master në udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve.
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës: Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët të niveleve tjera (SHFMU).

Aplikacioni duhet të përmbajë këto dokumente:

Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës (secili konkurrues dorëzon kopjen e vërtetuar-noterizuar të diplomës Bachelor-/Master;

Në arsimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët, duhet të jetë profili arsimor në bazë të normativit profesional për arsimin e përgjithshëm;

Për shkollat profesionale, kandidatit/ja duhet të jetë i profilit përkatës për institucionin edukativo-arsimor ku konkurren, në bazë të normativit për arsimin profesional;

Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;

Dëshmi për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;

Kandidati/ja për drejtor dhe zëvendës drejtor nuk mund të jenë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit;

Certifikatën e lindjes;

Certifikata që nuk jeni nën hetime;

Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).

Portfolio profesionale duhet të përmbajë:

1.Biografinë e shkurtër të kandidatit.

2.Konceptin e Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor, bazuar në pesë fushat e cilësisë së performancës së shkollës (5-10 faqe). Koncepti duhet të ketë 5-10 faqe tekst (minimumi një faqe për një fushë të cilësisë) më hapësirë 1.5, fronti i shkronjave 12, arial).

3.Certifikatat që dëshmojnë përfundimin e programeve të zhvillimit profesional në fushën e administrimit, menaxhimit dhe udhëheqjes, si dhe dëshmi tjera që elaborojnë përfundimin dhe realizimin e pjesëve të programit dhe demonstrojnë shkathësit e fituara.

4.Certifikatat që dëshmojnë përfundimin e suksesshëm të programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si dëshmi tjera rreth realizimit të atyre programeve.

5.Letër motivuese për pozitën që aplikon.

6.Dëshmi për aktivitete tjera në proceset e zhvillimit të arsimit (zhvillimi i kurrikulave, udhëheqja e programeve të zhvillimit profesional, pjesëmarrja dhe kontributi në konferenca, etj).

7.Dëshmi nga përvoja paraprake në menaxhim (shembuj të projekteve, shembuj të shkrimeve nga fusha fusha e menaxhimit, shembuj të planeve për zhvillimin e institucionit edukativo-arsimor që janë zhvilluar dhe/apo implementuar me udhëheqje apo kontributin tuaj konkret).

8. Dëshmi nga përvoja paraprake në mësimdhënie (shembuj të planeve të mësimi, shembuj të projekteve, kopje të punimeve, mirënjohje, etj).

9.Letër referencë më përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik-kredibil, drejtpërdrejtë e lidhur me punën tuaj dhe për konkursin përkatës (si Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DKA, këshilli drejtues i institucionit edukativo-arsimor, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe dhe projekte të ndryshme për arsim).

Afati dhe mënyra e publikimit:

30 ditë nga data e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data **16.02.2023 deri me 02.03.2023 (16:00)**

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet duhet ti shkarkojnë nga portali shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe faqen zyrtare të komunës, dhe të plotësojnë ti dorëzojnë në Drejtorin për Arsim, (Zyrën nr. 52). Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit. Mirëpriten aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraprak nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Për çdo paqartësi aplikuesit i drejtohen DKA-së, zyra nr.52 Kati-III.

Rezultatet shpallen në web faqen e komunës së Deçanit <https://kk.rks-gov.net/decan/category/njoftimetshpalljet/>

